

## KONTRATË

**E lidhur në Gjakovë, me dt.14.10.2020, në mes të:**

**Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit** (në tekstin e mëtejme Autoriteti kontraktues)nga njëra anë dhe

**“Ballkan Petrol” sh.p.k. - Ferizaj, me nr.unik 810080036**, e përfaqësuar nga z.Bekim Aliti (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin kontrate për punët si ne vijim:

### TITULLI I KONTRATËS – “Furnizim me antifriz”

**Nr. i prokurimit- 632-20-4741-1-3-6**

**Nr. i brendshëm-632-20-075-136**

#### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës është **Furnizim me antifriz**, nga Kontraktuesi, sipas specifikave të dhëna nga **Drejtoria për Arsim**, si vijon:
- 1.2 Kontrata do të nënshkruhet dhe hynë në fuqi me **dt.14.10.2020** dhe do të përfundoj brenda **6 muajsh**.
- 1.3 Kontraktuesi duhet të kryej punët në pajtushmëri të plotë me Kushtet e kontratës ,specifikimet e detyrueshme teknike dhe paramasën me paralogari, përndryshe kontrata do të ndërpritet.
- 1.4 Vendi i kryerjes së punimeve është në **në shkollat e Komunës së Gjakovës**, sipas urdhëresës me shkrim nga Menaxheri i projektit.
- 1.5 Mbikëqyerja dhe pranimi i furnizimeve do të bëhet nga Komisioni për pranim të furnizimeve në përbërje prej : drejtorët me dy anëtar të stafit të secilës shkollë ku bëhet furnizimi

1.6 Menaxher i projektit është Elvane Qarkaxhija, mob.044/204-028 & 045/103-820.

1.7 Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës që do të përcjellë implementimin e kontratës, kualitetin e furnizimeve dhe njëherit do të bëjë vlerësimin e furnizimeve të realizuara dhe do të kërkojë nga kontraktuesi eliminimin e çfarëdo defekti gjatë kryerjes së furnizimeve.

1.8 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

## **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës bashkë me tvsh është: **2,838.00€ (dymijë e tetëqind e tridhjetë e tetë euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

## **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa bëhet pas dorëzimit të procesit të pranimit të punimeve dhe faturës .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

## **Neni 5            Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6            Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *punimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, në të kundërt punimet nuk do të pranohen dhe do të shkëputet kontrata.

## **Neni 7    Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *punimeve*.

## **Neni 8            Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *punëve* të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9            Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e punimeve, për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10          Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11        Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12        Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13        Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.





## **Neni 14        Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në katër origjinale, tre origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik**

**Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	z. Bekim Aliti	<b>Emri:</b>	Komuna e Gjakovës - z.Faton Gutaj
<b>Pozita:</b>	Drejtor	<b>Pozita:</b>	Menaxher i Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	14.10.2020	<b>Data:</b>	14.10.2020
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Furnizim me antifriz

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Sigurimi dhe furnizimi i antifrizit për sistemin e ngrohjes qendrore. Antifrizi të jetë tip "100% ose me karakteristika të ngjashme, i cili përzihet me ujin e rrjetit të ngrohjes. Llogaria bëhet për litër.	litër	2200	1.29	2,838.00
<b>Gjithsej totali me TVSH</b>					<b>2,838.00</b>



## PJESA V E KONTRATES: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	"BALLKAN PETROL" SH.P.K.
Adresa	ZONA INDUSTRIALE GERLICE
Qyteti	FERIZAJ
Kodi Postar	70000
Kontakti	IMRI HALITI
Telefoni	049/113 543
Fax	
E-mail	info@ballkanpetrol.com
Numri i TVSH	330375320

BANKA	
Emri	BANKA PËR BIZNES
Adresa	RR. DËSHMORËT E KOMBIT
Qyteti	FERIZAJ
Kodi Postar	70000
Shteti	KOSOVË
Llogaria Bankare	1304001002528353
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

### SHËNIME:

